

Vendim nr. 144 datë 25.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Ilir Toska, Anëtar

në datën 25.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (T) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: TONIN KAZA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4802, datë 21.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Tonin Kaza ka qenë në marrëdhënie pune pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (*DPT*) në detyra të ndryshme, së fundi në detyrën e inspektorit të dytë në sektorin e

Kontrollit Tatimor dhe Verifikimit në Terren. Përmes shkresës nr. 25855 prot., datë 30.09.2014, me lëndë “Konstatim shkeljeje disiplinore”, Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion) në DPT ka propozuar fillimin e ecurisë disiplinore ndaj kërkuesit për shkeljen shumë të rëndë, atë të “Mospërmbushjes së detyrave funksionale”, të parashikuar nga neni 57, pika 2, shkronja “a”, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (*ligji nr. 152/2013*). Shkelja e kërkuesit konsistonte në faktin se ai, në muajt maj-qershor 2014, gjatë orarit zyrtar, në mënyrë të përsëritur (në 4 raste), është larguar nga puna dhe ka udhëtuar jashtë vendit pa njoftuar eprorin, ndërkohë që ka përfituar pagën e plotë. Me shkresën nr. 25855/1 prot., datë 06.10.2014, drejtori i përgjithshëm i Tatimeve ia ka përcjellë atë komisionit disiplinor pranë DPT-së. Në ecurinë disiplinore të filluar ndaj kërkuesit, pasi ai është dëgjuar nga komisioni disiplinor në seancën e datës 21.10.2014, gjatë së cilës ai ka paraqitur shpjegimet dhe pretendimet e tij për shkeljet disiplinore të atribuara, me vendimin nr. 1515, datë 07.11.2014, komisioni disiplinor ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” (*akti i largimit nga Shërbimi Civil*).

2. Në datën 16.12.2014 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi në objektin e së cilës ka kërkuar: i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve, si dhe të veprimeve të mëtejshme në lidhje me fillimin e ecurisë disiplinore; ii) konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit për largimin nga Shërbimi Civil; iii) kthimin në të njëjtin pozicion pune sipas strukturës së re organizative; iv) rregullimin e pasojave financiare të shkaktuara nga momenti i daljes së vendimit për largimin nga detyra, deri në ditën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, duke i paguar pagën sipas kategorisë dhe pozicionit të punës, përfshirë edhe shtesat sipas kualifikimeve ose indeksimit, ose rritjes së pagës.

3. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 586, datë 11.02.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit. Ky vendim, pas ankimimit të tij të kërkuesit, është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 4250 (86-2017-4488), datë 17.10.2017. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4802, datë 21.11.2023, ka vendosur mospranimin e tij.

4. Në datën 26.04.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, përmes të cilit ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuetit

5. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga procesi gjyqësor i kundërshtuar i është cenuar:

5.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

5.1.1. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj.*

5.1.2. *Së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e faktit kanë rrëzuar padinë pa shqyrtuar çështjen në themel, duke mos përmbushur detyrimin që rrjedh nga vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë nr. 3/2012 dhe nr. 7/2011. Ato janë kufizuar vetëm në shqyrtimin e pikës së parë të objektit të padisë, ndërkohë që nga përmbajtja e saj, veçanërisht në pjesën përfundimtare, është kërkuar edhe konstatimi i paligjshmërisë së vendimit për largimin nga Shërbimi Civil. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit duke iu referuar përcaktimeve të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji nr. 49/2012), të ndryshuar me ligjin nr. 39/2017, datë 30.3.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar” (ligji nr. 39/2017), i cili ka ngushtuar hapësirën e shkaqeve për të cilat mund të bëhet rekurs, gjë e cila është bërë gjatë kohës që çështja ka qenë në gjykim, ndaj, nisur nga kjo ajo gjykatë, duhet të kishte bërë një interpretim pajtues me Kushtetutën të kësaj dispozite dhe të pranonte për shqyrtim rekursin e kërkuetit ose duhet t’ia dërgonte çështjen Gjykatës për kontroll incidental të kësaj dispozite, e cila në këto kushte duhet ta shfuqizojë atë si të papajtueshme me Kushtetutën.

5.1.3. *Së drejtës për t’u mbrojtur dhe dëgjuar të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, duke i mohuar kërkuetit mundësinë e realizimit të një mbrojtjeje efektive të drejtpërdrejtë. Nëse Gjykata e Lartë do ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me siguri do të kishte konstatuar mosshqyrtimin e çështjes në themel nga gjykatat më të ulëta, përveçse vlerësimin e gabuar të provave nga ato dhe në këto rrethana do t’i cilësonte ato

drejtë juridikisht, duke e zgjidhur vetë çështjen në themel për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material ose duke e kthyer çështjen për rigjykim me orientimet përkatëse.

5.1.4. *Së drejtës së ankimit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, duke mos u shprehur për shkaqet e ngritura në të, duke i hequr atij mundësinë për të pasur një trajtim të pretendimeve të tij për çështje të faktit dhe ligjit nga ana e kësaj gjykate.

5.2. *E drejta për punë*, e garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, për shkak të veprimit të organit shtetëror që ka sjellë pasojat të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale të kërkuarit, ndërkohë që gjykatat nuk ia kanë rivendosur në vend këtë të drejtë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neni 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e neni 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

7. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, krahas vendimit gjyqësor, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave

kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në çështjen konkrete, kërkuesi në objektin e ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, ndërsa në përmbajtjen e tij ka kundërshtuar edhe vendimet e gjykatave më të ulëta të marra në atë proces gjyqësor ku ai ka qenë palë ndërgjyqëse. Po kështu, kërkuesi ka kundërshtuar edhe ligjin nr. 39/2017 (nenin 5), që ka ndryshuar nenin 58, të ligjit nr. 49/2012. Në lidhje me vendimet gjyqësore, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të tij, duke mos e shqyrtuar në themel çështjen e ngritur nga ai dhe në këtë mënyrë i kanë mohuar të drejtën e aksesit, se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, duke i mohuar të drejtën për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, se Gjykata e Lartë nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs, duke i mohuar të drejtën e ankimit, të drejta këto të lidhura edhe me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Për sa i takon dispozitës ligjore të kundërshtuar, kërkuesi ka pretenduar se ajo është miratuar gjatë kohës kur çështja e tij ka qenë në gjykim dhe, në raport me përmbajtjen e mëparshme të saj, kjo dispozitë ka ngushtuar hapësirën e shkaqeve për të cilat mund të bëhet rekurs, ndaj zbatimi i saj i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë.

9. Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kërkuesit është me natyrë administrative, ndaj shkaqet për të cilat lejohet rekursi në Gjykatën e Lartë rregullohen nga ligji nr. 49/2012. Neni 58 i këtij ligji, sipas përmbajtjes së tij fillestare, parashikonte se vendimet e shpallura nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë mund të ankimohen me rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm kur: a) ligji material nuk është respektuar, është interpretuar ose zbatuar keq, ose vendimi i dhënë është në kundërshtim me

një vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit; c) ka shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit. Kjo dispozitë është ndryshuar me ligjin nr. 39/2017 (neni 5), që ka hyrë në fuqi në datën 06.05.2017, i cili tashmë parashikon se vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë, në këto raste: a) për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika e Kolegjit Administrativ ose e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; c) për shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit. Kolegji konstaton se neni 58 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 39/2017, që kundërshtohet nga kërkuesi, nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore dhe zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata në procesin që ajo zhvillon, duke përmbushur në këtë mënyrë kushtin e efektit të drejtpërdrejtë që parashikohet nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i ligjit nr. 8577/2000. Kjo dispozitë ligjore është përdorur nga Gjykata e Lartë në rastin e shqyrtimit të rekursit të kërkuesit.

10. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi i mjeteve juridike përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe së drejtës për t’u mbrojtur e dëgjuar, për sa i përket procesit

gjyqësor të zhvilluar dhomën e këshillimit në gjykatën e apelit. Kolegji vëren se kërkuesi nuk i ka ngritur këto pretendime në rekursin e tij drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, për këto pretendime, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

13. Ndërsa për pretendimet e tjera që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, së drejtës për t’u mbrojtur dhe dëgjuar në Gjykatën e Lartë, si dhe të drejtën e ankimit, të lidhura me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, kërkuesi i ka ngritur, në thelb, në rekurs ose ato lidhen me procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për të cilin ligji nuk parashikon mjete të zakonshme ankimi. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këto pretendime plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi kërkuesi nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion, përveç ankimit kushtetues individual.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsytuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 40, datë 14.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-4802, datë 21.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 26.04.2024. Me shkresën nr. 404/1, datë 29.01.2024, Gjykata e Lartë ka informuar kërkuesin se vendimi gjyqësor është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 29.12.2023, datë në të cilën palët mund ta dispononin këtë vendim. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuesi e ka paraqitur ankimin kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor, prandaj ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

16. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, së drejtës për t’u mbrojtur dhe dëgjuar në Gjykatën e Lartë, si dhe së drejtës së ankimit të lidhura me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për punë. Këto pretendime janë me natyrë kushtetuese, ndaj hyjnë në kompetencën e Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

17. Në lidhje me pretendimin e cenimit të *së drejtës për t'u mbrojtur dhe dëgjuar*, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, duke i mohuar mundësinë e realizimit të një mbrojtjeje efektive të drejtpërdrejtë. Sipas tij, nëse Gjykata e Lartë do ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore do të kishte konstatuar mosshqyrtimin e çështjes në themel nga gjykatat më të ulëta, përveçse vlerësimin e gabuar të provave nga ato dhe, në këto rrethana, do t'i cilësonte ato drejtë juridikisht, duke e zgjidhur vetë çështjen në themel, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material ose duke e kthyer çështjen për rigjykim me orientimet përkatëse. Nga argumentet e parashtruara, Kolegji vëren se pretendimi i kërkuesit, në thelb, lidhet me formën e gjykimin të çështjes së tij nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit, në dhomën e këshillimit, ka kryer shqyrtimin paraprak të rekursit të kërkuesit, duke arritur në përfundimin se ai nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim në seancë gjyqësore (pa ose me praninë e palëve). Sipas ligjit procedural, shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Në këto kushte, shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjykimin të përcaktuar nga ligji. Për më tepër, një formë e tillë gjykimi edhe në rastet kur rekursi ka kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, nuk është vlerësuar nga Gjykata se cenon të drejtën e palëve për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, duke u shprehur se shqyrtimi i rekursit në seancë në dhomën e këshillimit, pra mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr.41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, kjo e drejtë realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve (*shih vendimin nr. 43, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së ankimit*, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tij, duke mos u shprehur për shkaqet e ngritura në të dhe duke i hequr atij mundësinë për të pasur një trajtim të pretendimeve për çështje të faktit dhe ligjit nga ana e kësaj gjykate. Nisur nga natyra argumenteve të parashtruara, Kolegji vlerëson që këtë pretendim ta trajtojë në kuadër të pretendimit të kërkuesit për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*.

19. Për pretendimin e kërkuesit për cenimin e *së drejtës për punë*, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, duke mbajtur në konsideratë se argumentet për këtë pretendim lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji vlerëson ta shqyrtojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa

një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

20. Për sa më lart, Kolegji vlerëson të analizojë në vijim vetëm pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit*, Kolegji vëren se ai bazohet në dy shkaqe: i) përmbajtjes së dispozitës së ligjit të kundërshtuar; ii) mënyrës së zbatimit të saj nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji do të shqyrtojë fillimisht kushtetutshmërinë e dispozitës ligjore dhe, në vijim, mënyrën e zbatimit të saj nga Gjykata e Lartë, krahas pretendimeve të tjera për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial për shkak të përmbajtjes së ligjit

21. Kërkuesi ka pretenduar se ligji nr. 39/2017 (neni 5), duke ndryshuar nenin 58 të ligjit nr. 40/2012, ka ngushtuar hapësirën e shkaqeve për të cilat mund të bëhet rekurs, duke u cenuar palëve të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, ndaj është i papajtueshëm me Kushtetutën.

22. Kolegji konstaton se, si edhe më lart u parashtrua, shkaqet për të cilat lejohet rekursi ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit përcaktohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, dispozitë kjo që është ndryshuar me ligjin nr. 39/2017 (neni 5). Po kështu, Kolegji konstaton se përpara miratimit të këtij ligji është ndryshuar neni 141 i Kushtetutës me ligjin kushtetues nr. 76/2016, datë 22.07.2016. Përmes ndryshimit të kësaj dispozite të Kushtetutës, janë prekur kompetencat e Gjykatës së Lartë, e cila tashmë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. Pikërisht, për shkak të delegimit që neni 141 i Kushtetutës ka bërë te ligji, Kuvendi ka miratuar ndryshimet ligjore të nevojshme për zbatimin e kompetencave të reja kushtetuese të Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 17, datë 30.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), ku në këtë kuadër është miratuar edhe ligji nr. 39/2017, i cili ka hyrë në fuqi në datën 06.05.2017.

23. Kolegji vëren se ligji nr. 39/2017 (neni 5), për sa ka ndryshuar nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, është bërë me qëllim harmonizimin e legjislacionit me Kushtetutën, për sa u përket kompetencave të reja të përcaktuara për Gjykatën e Lartë. I vetmi ngushtim i shkaqeve të rekursit që vjen nga ligji nr. 39/2017 ka të bëjë me shkallën e rëndësisë së zbatimit të gabuar të ligjit material ose procedural nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa kërkohet që ky zbatim i gabuar i ligjit të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës

gjqësore. Ky parashikim është i njëjtë me atë të bërë nga Kushtetuta në nenin 141, pika 1, për sa i përket kompetencës së Gjykatës së Lartë. Nisur nga kjo, ngushtimi nga ligji i hapësirës së shkaqeve për rekurs është e lidhur me kompetencat e reja më të ngushta të Gjykatës së Lartë, kompetenca këto që i ka përcaktuar Kushtetuta, ndaj kufizimi i pretenduar nga kërkuesi, praktikisht, nuk ka të bëjë me ligjin, por me Kushtetutën. Për rrjedhojë, Kolegji e vlerëson haptazi të pabazuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit për shkak të papajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 39/2017 (neni 5) për sa ka ndryshuar nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit duke iu referuar përcaktimeve të nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar me ligjin nr. 39/2017, i cili ka ngushtuar hapësirën e shkaqeve për të cilat mund të bëhet rekurs, gjë e cila është bërë gjatë kohës që çështja ka qenë në gjykim, ndaj, nisur nga kjo, ajo gjykatë duhej të kishte bërë një interpretim pajtues me Kushtetutën të kësaj dispozite dhe të pranonte për shqyrtim rekursin e tij.

25. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë rrëzuar padinë pa shqyrtuar çështjen në themel, duke mos përmbushur detyrimin që rrjedh nga vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë nr. 3/2012 dhe nr. 7/2011. Gjykatat, vijon kërkuesi, janë kufizuar vetëm në shqyrtimin e pikës së parë të objektit të padisë, ndërkohë që nga përmbajtja e saj, veçanërisht në pjesën përfundimtare, është kërkuar edhe konstatimi i paligjshmërisë së vendimit për largimin nga Shërbimi Civil. Sipas kërkuesit, pavarësisht mënyrës së formulimit të kërkimeve në kërkesëpadi dhe në aktet e tjera të procesit gjyqësor, për sa kohë ato kanë lidhje me pretendime që burojnë nga marrëdhënia e punës, ka qenë detyrë e gjykatave të hetonin në lidhje me to dhe të zgjidhnin pasojat përkatëse në zbatim të ligjit nr. 152/2013. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tij, duke mos u shprehur për shkaqet e ngritura në të dhe hequr atij mundësinë për të pasur një trajtim të pretendimeve për çështje të faktit dhe ligjit nga ana e kësaj gjykate.

26. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar neni 42, pika 1, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të

drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesimi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse dhe se arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 27, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në lidhje me pretendimin e ngritur për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, Kolegji vëren se ligji nr. 39/2017 (neni 5) për sa ka ndryshuar nenin 58 të

ligjit nr. 49/2012, ka karakter procedural dhe, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, zbatohet në përputhje me parimin *tempus regit processum*, sipas të cilit ligji i ri procedural ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, për sa kohë nuk cenon interesa ose të drejta procedurale të palëve të njohura ose të garantuara nga ligji i mëparshëm. Ligji nr. 39/2017, në dispozitat kalimtare, nuk parashikon moszbatimin e kësaj dispozite ose të ndryshimeve të tij në përgjithësi për çështjet që në momentin e hyrjes së tij në fuqi janë në gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

30. Në rastin në shqyrtim, Kolegji konstaton se vendimi nga Gjykata Administrative e Apelit është dhënë në datën 17.10.2017, ndërsa kërkuesi e ka paraqitur rekursin e tij në datën 21.12.2017, pra shumë muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 39/2017. Nisur nga kjo, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë ka zbatuar ligjin procedural që ka qenë në fuqi në momentin e dhënies së vendimit nga Gjykata Administrative e Apelit dhe lindjes së të drejtës së rekursit për kërkuesin, ligj në bazë të të cilit ai edhe e ka ushtruar këtë të drejtë. Ajo gjykatë nuk i ka mohuar kërkuesit të drejtën e rekursit, e drejtë kjo e garantuar nga ligji i mëparshëm dhe e rikonfirmuar edhe nga ligji i ri. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë e ka interpretuar dhe zbatuar ligjin nr. 39/2017 (neni 5) në lidhje me rrethin e shkaqeve të rekursit, në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese. Nëse ajo do të vepronte, sikurse kërkuesi ka pretenduar, do të rrezikonte kapërcimin e këtyre kompetencave, për rrjedhojë pretendimi i tij për cenimin e së drejtës së aksesit për shkak të mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, është haptazi i pabazuar.

31. Në lidhje me pretendimet e tjera, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi, i cili me padinë e tij ka kërkuar: i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve, si dhe të veprimeve të mëtejshme në lidhje me fillimin e ecurisë disiplinore; ii) konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit për largimin nga Shërbimi Civil; iii) kthimin në të njëjtin pozicion pune sipas strukturës së re organizative; iv) rregullimin e pasojave financiare të shkaktuara nga momenti i daljes së vendimit për largimin nga detyra dhe deri në ditën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, duke i paguar pagën sipas kategorisë dhe pozicionit të punës përfshirë edhe shtesat sipas kualifikimeve ose indeksimit, ose rritjes së pagës. Në përmbajtje të padisë, në lidhje me pavlefshmërinë absolute të pretenduar të akteve në objektin e padisë, kërkuesi ka parashtruar si shkak atë të nxjerrjes së tyre në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji, duke evidentuar faktet dhe parashikimet ligjore përkatëse në këtë drejtim. Po kështu, në përmbajtje

të padisë, kërkuesi ka parashtruar edhe pretendime në lidhje me faktet e klasifikuara si shkelje disiplinore, ashtu edhe për përshtatshmërinë e masës disiplinore të dhënë ndaj tij.

32. Në përfundim të shqyrtimit të padisë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e saj. Sipas gjykatës, paditësi (kërkuesi) në padinë e tij ka kërkuar vetëm konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të largimit të tij nga Shërbimi Civil, mbi shkakun e nxjerrjes së tij në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji sipas nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative (miratuar me ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999). Nisur nga kjo, duke mbajtur parasysh edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ajo gjykatë ka vlerësuar se, referuar provave të administruara në gjykim dhe në respektim të parimit të barrës së provës, kërkuesi nuk ka arritur të provojë se akti administrativ i kundërshtuar të jetë nxjerrë në shkelje flagrante ligjit për sa i përket procedurës së ndjekur nga organi i administratës publike. Nga ana tjetër, sipas asaj gjykate, pretendimet e paditësit në lidhje me faktet në themel të shkeljes disiplinore dhe për sa i përket justifikimit të masës së dhënë për atë shkelje, nuk mund të përbëjnë shkak për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ të largimit nga Shërbimi Civil, por për pavlefshmërinë relative të këtij akti, gjë e cila nuk është kërkuar nga paditësi.

33. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Edhe gjykata e apelit ka vërejtur se në objektin e padisë së tij ankuesi (kërkuesi) ka kërkuar pavlefshmërinë absolute të procedurës disiplinore të ndjekur kundrejt tij. Nisur nga kjo, ajo gjykatë ka vlerësuar se, ndryshe nga sa pretendohet në ankim, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë, dhe në përputhje me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 00-2013-1160(110), datë 12.02.2013; nr. 00-2013-2341(542), datë 03.10.2013 të Gjykatës së Lartë*), e ka kufizuar hetimin gjyqësor të çështjes rreth pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të largimit të ankuesit nga Shërbimi Civil. Në vijim, në analizë të pretendimeve në ankim, të rrethanave të faktit dhe të ligjit, gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë rrëzimin e padisë nga gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar se akti administrativ objekt i shqyrtimit gjyqësor është i vlefshëm, pasi është marrë nga organi publik kompetent, në zbatim të kompetencave të njohura nga legjislacioni për nëpunësin civil, si dhe duke ndjekur një procedurë administrative të rregullt, në përputhje të plotë me aktet normative relevante.

34. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në të nuk ngriheshin shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, ndërsa për sa u përket pretendimeve në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave, ato dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

35. Në analizë të vendimeve gjyqësore të lartpërmendura, Kolegji konstaton se kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e padisë dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes dhe në respektim të së drejtës së disponimit të palës që e ka vënë në lëvizje atë, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje për atë që i ka kërkuar gjykatës. Vendimet e gjykatave të faktit tregojnë mjaftueshëm rrethanat e çështjes, kërkimet në padi, pretendimet e parashtruara nga palët, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë, duke iu dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, qoftë atyre në padi, ashtu edhe në ankim, duke i argumentuar ato lidhur me respektimin e procedurës së ndjekur nga organi i administratës publike në nxjerrjen e aktit administrativ të largimit të kërkuesit nga Shërbimi Civil, i cili ka qenë edhe shkaku i padisë së ngritur nga ai. Po kështu, ato kanë evidentuar edhe pretendimet e kërkuesit në lidhje me faktin, shkeljen dhe përshtatshmërinë e masës disiplinore, por ndryshe nga ai, kanë vlerësuar se ato nuk kanë të bëjnë me procedurën e nxjerrjes së aktit dhe as mund të përbënin shkak për pavlefshmërinë absolute të tij. Këto vendime i janë nënshtruar kontrollit nga Gjykata e Lartë, e cila, pavarësisht arsyesimit të kufizuar, ka evidentuar rrethanat e rastit dhe ecurinë e procesit gjyqësor në gjykatat më të ulëta, përfshirë dhe vendimmarrjet dhe argumentet e tyre, sikundër po ashtu ka evidentuar edhe shkaqet e parashtruara në rekursin e kërkuesit, duke vlerësuar se ai nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim, pra se shkaqet e ngritura në të nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji ose janë haptazi të pabazuara. Në këtë kuptim, pretendimi i kërkuesit për cenimin e aksesit substancial dhe standardin e arsyesimit në lidhje me vendimet e gjykatave të zakonshme, është haptazi i pabazuar.

36. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.